



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Nr. _____ Prot.

Berat , me 12.12.2024

PROCES VERBAL

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

▪ **OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje mjete per sherbimet mbeshtetese te administrates ”
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):;
44510000-8 mjete

- **VLERA E FONDIT LIMIT:** 3 930 000 (tre milion e nwnwtqinde e tridhjete mije) leke pa tvsh.
- Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021 ne vleren :
Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Bashkia BERAT** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme të përcaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës; në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

“Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi bazuar ne vleren e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.3. Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga entit publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku te shenohen, vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe/ose fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne të cilin parashikohet se:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne të cilin është e percaktuar se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

4. Katalog teknik të mallit ku të markohen (nënvizohen) për lehtësi identifikimi specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 5 të DST-së. Katalogu duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi.

5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjeti është prodhuar për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën .

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi.

6. Deklaratë garancie për mallrat e ofruar, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë minimum 3 vite për automjetin dhe minimumi 8 vite për baterinë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit. Çdo prodhues ose distributor shitës ofron garanci për automjetet e reja për një afat të caktuar. AK-ja ka kërkuar një afat minimal prej 3 vite për automjetin dhe minimumi 8 vite për baterinë, e cila mbulon defekte (probleme) që vijnë nga prodhimi pas blerjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

7. Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuara dhe regjistruara në pronësi të AK, ku në çmim të jenë përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracioni dhe kolaudimi.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i pune i krijuar për hartimin e e projektit ,preventivit, afatit të punimeve dhe relacionin teknik , në përputhje me nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur D.S.T-ve në S.P.E.